



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008 e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr. 03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.27/2008, e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b) lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miraton këtë:

Projekt - V E N D I M

Për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2022 në projektet kapitale .

Neni 1

1.1 Në bazë të Ligjit të Buxhetit NR.08/L-066 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2022 nga Rezervat e projekteve kapitale që duhet të buxhetohen në projekte kapitale është shuma prej **624,989.00€ (510,000.00€+114,989.00€)** e që në total i bie shuma prej **624,989.00€** si rezervë e cila duhet të kalojë në kategorinë aktive të projekteve kapitale.

1.2 Shuma e lartshënuar do të transferohet- alokohet në këto projekte kapitale të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret sipas UA-NR.04/2019 dhe UA-NR.06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale e që tani konsiderojmë se janë plotësuar kërkesat e Udhëzimeve Administrative në fjalë.

Neni 2

Lista e projekteve kapitale që kalojnë nga Rezervat në projekte kapitale për vitin fiskal 2022.

Programi	Kodi i Programit	Kodi i Projektit	Emërtimi i Projektit	10-BKK 2022	21-THV 2022	Totali 2022
624180-Sherbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia						
180120-Infrastruktura Rrugore-Suhareke						
180	18012	52024	Projektet me bashkëfinancim	100,000.00	45,000.00	145,000.00
470	47012	52024	Projektet me bashkëfinancim		59,989.00	59,989.00
160	16623	52024	Projektet me bashkëfinancim		10,000.00	10,000.00
Totali -Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia				100,000.00	114,989.00	214,989.00
624470-Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural						
470120-Bujqësia -Suharekë						
470	47012	Projekt I Ri	Ndërtimi dhe rregullimi i Kolektorit në rrugën “Skënderbeu”-Suharekë	410,000.00		410,000.00
Totali -Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural				410,000.00		410,000.00
TOTALI KOMUNAL :				510,000.00	114,989.00	624,989.00

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr.03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren(QRK) Nr.06/2021 të dates 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI